

VENDIM
Nr. 680, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 714, DATË 24.11.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘HALIT COKA’, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 714, datë 24.11.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka”, Bashkia Kamzë, në masën 309 893 727,32 (treqind e nëntë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet e shtatë presje tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

b) Në pikën 3, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2 dhe 2.1 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku